

Të nderuar pjesëmarrës!

Në këtë diskutim, dëshiroj të evidentoj disa çështje kryesore lidhur me aksesin në drejtësi të viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore për të kërkuar shpërblimin e dëmit, rasti i Shqipërisë. Në legjislacionin shqiptar janë parashikuar mekanizmat ligjorë për kërkimin e dëmit të ardhur nga vepra penale, si përmes procesit penal edhe atij civil. Prosesi civil mundëson që viktimat të kërkojnë jo vetëm dëmin material, por edhe atë moral. Që nga viti 2004, kur hyri në fuqi ligji “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, teorikisht, ekziston edhe mundësia për dëmshpërblimin e viktimave në rrugë administrative përmes të ardhurave të krijuara nga konfiskimi i pasurive kriminale, por në praktikë nuk kemi ende raste të zbatimit të tij.

Vitet e fundit, përmes bashkëpunimit të organizatave jofitimprurëse me organet kompetente shtetërore, ka një lëvizje shoqërore e profesionale për një kuptim më të drejtë të institutit të shpërblimit të dëmit, si pjesë e rëndësishme e drejtësisë. Ky komponent u pasqyrua në një vend të rëndësishëm të strategjisë së Qeverisë për luftën kundër trafikut të qenieve njerëzore. Kjo lëvizje synon të përmbysë konceptet e vjetra tradicionale që ekzistojnë në shoqërinë shqiptare, se “Nderi dhe jeta nuk blihen me para”.

Ndërkohë që, ka pasur dhe ka ende koncepte të gabuara të nëpunësve të shtetit, sipas të cilëve duhet të japim njëherë drejtësi duke dënuar autorët e krimit, pastaj të mendojmë për shpërblimin e dëmit. Puna e zhvilluar përmes trajnimeve e diskutimeve, është shoqëruar edhe me kërkesa drejtuar gjykatës për shpërblimin e dëmit, në emër të viktimave, që janë nxitur dhe mbështetur nga organizatat jofitimprurëse dhe grupe të interesit.

Megjithatë, nga monitorimi i praktikës gjyqësore shqiptare, rezulton se ka shumë pak raste të kërkimit të shpërblimit të dëmit të ardhur nga vepra penale në përgjithësi, e akoma më pak, nga veprat e trafikimit të qenieve njerëzore. Kjo për shkak se, viktimat e trafikimit kanë nevojë për më tepër mbështetje dhe siguri. Ato janë shpesh të frikësuar dhe nuk kërkojnë shpërblimin e dëmit, apo të drejta të tjera. Disa mangësi në legjislacionin shqiptar, nuk kanë bërë të mundur informimin e tyre mbi këtë të drejtë, si dhe ofrimin e ndihmës ligjore falas. Ka nevojë që ligji shqiptar të plotësohet duke

parashikuar shprehimisht të drejtën e viktimave që të informohen, si dhe organin kompetent shtetëror që detyrohet të japë këtë informacion. Në këtë kuadër, është e nevojshme të parashikohet ndihma ligjore falas, si dhe përfaqësimi ligjor i viktimës. Këto të fundit, janë të nevojshme për të rritur mundësitë e viktimës të kryejë procedurat dhe të marrë shpërblimin. Mungesa e një avokati kryesisht (*ex officio*), e dobëson pozitën e saj në procesin penal dhe sidomos, dobëson punën për informimin e viktimës në lidhje me të drejtat për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Gjithashtu, është e rëndësishme që viktimat të përjashtohen nga pagimi i taksave gjyqësore. Pagimi i taksave dhe i vlerës së padisë nga viktima që ngre padinë civile në procesin penal, do të përbënte një pengesë serioze për kërkimin e shpërblimit të dëmit.

Ne, si organizata jofitimprurëse që veprojmë në këtë fushë, shfrytëzojmë çdo hapësirë ligjore për të interpretuar ligjin në mbështetje të viktimave. Kështu, kemi menduar të punojmë për të siguruar ndihmë ligjore falas për viktimat, në kuadër të zbatimit të ligjit që ka hyrë rishtazi në fuqi, “Për ndihmën Ligjore”, i cili parashikon mekanizmat për të ofruar ndihmë ligjore falas nga shteti, për njerëzit pa të ardhura.

Ndihma ligjore falas, është e nevojshme sidomos në fazën e ekzekutimit të vendimit të gjykatës për shpërblimin e dëmit. Edhe këtu viktima ka një rol aktiv dhe ka nevojë për mbështetje. Në ato raste që kemi monitoruar, kemi konstatuar se mbeten të paekzekutuara vendimet për shpërblimin e dëmit, për shkak se viktima nuk paraqitet.

E gjithë kjo lëvizje ka nevojë të shoqërohet jo vetëm me përmirësime ligjore në disa ligje e akte të brendshme, por edhe me edukim e trajnim të vazhdueshëm të nëpunësve shtetërorë për rritjen e kapaciteteve dhe profesionalizmit të tyre. Në këtë kuadër, përgatitja e guidave, formularëve apo skemave orientuese mendojmë se do të jenë shumë efikase, krahas trajnimeve për zbatimin e tyre. Në përfundim, dëshiroj të theksoj edhe njëherë se sa e rëndësishme është të kuptohet se, forcimi i elementit demshpërblim në dhënien e drejtësisë, ndihmon në rritjen e efektivitetit të saj.